



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në pajtim me dispozitat e nenit 14, pika 14.1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dispozitat e nenit 11 të Rregullores për dhënien e banesave të komunës në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteraneve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, 01 nr. 360 - 2803, të dt. 6.12.2011, Komisioni për çështje banesore, më 2.2.2012 mori Vendim për shpalljen e

K O N K U R S I T

për

dhënien e 48 banesave, në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve dhe veteraneve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës

Të drejtë aplikimi, sipas dispozitave të nenit 7 të Rregullores, ka aplikuesi, i cili:

- a. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. të jetë banor i komunës së Prishtinës, së paku 10 vjet para kohës së aplikimit;
- c. të mos ketë banesë apo shtëpi në pronësi individuale në komunën e Prishtinës apo në komunat tjera në Kosovë;
- d. të mos ketë patundshmëri – tokë në komunën e Prishtinës apo në komunat tjera në Kosovë;
- e. të dëshmojë se është anëtar i familjes së dëshmorit, pjesëtar i UÇK – së, që ka rënë në luftë për lirinë e vendit në vitet 1998 – 1999;
- f. të jetë invalid, me dëmtim trupor së paku 10 %, në periudhën nga formimi i UÇK – së e deri më 20.6.1999;
- g. të jetë veteran kandidati i cili është regjistruar si ushtar nga Komanda – shtabet e zonave operative të UÇK – së, brenda periudhës 30.12.1991 – 30.6.1999.

Kriteret për vlerësim të aplikuesve janë të caktuar në nenin 9, pika 9.2 të Rregullores.

Aplikuesi kërkesës duhet bashkëngjitur këto prova:

- a. certifikatën e shtetësisë;
- b. lejen e njoftimit, me të cilën dëshmohet se është banor i komunës së Prishtinës;
- c. vërtetimin se nuk ka pasuri të paluajtshme, shtëpi apo banesë në pronësi të tij në komunën e Prishtinës;

- d. certifikatën e lindjes për secilin anëtar të familjes;
- e. vërtetimin mbi të ardhurat personale të tij dhe të anëtarëve të familjes.

Dokumentet e kërkuara nuk mund të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj nga dita e lëshimit të tyre.

Formularët për aplikim mund të merren dhe të dorëzohen në ndërtesën e Komunës së Prishtinës, rruga "UÇK", nr. 2, kati përdhësë, Qendrën për shërbim me qytetarët çdo ditë pune prej orës 8:30 deri në ora 15:00.

Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes në të përditshmet "Zëri" dhe "Koha ditore".

Aplikacionet e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren në shqyrtim.

Për informata shtesë njoftimi mund të bëhet përmes tel. 230 - 900 lok. 1123.